

VENDIM
Nr.195, datë 24.3.2010

PËR MIRATIMIN E FONDIT LIMIT TË SHPENZIMEVE TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVIZIONIT, PËR VITIN 2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin, publik e privat, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2010, në shumën 102.2 milionë lekë (njëqind e dy pikë dy milionë) lekë, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, i ndarë, si më poshtë vijon:

- a) 80.8 milionë lekë (tetëdhjetë pikë tetë milionë) lekë për shpenzime korente;
- b) 21.4 milionë lekë (njëzet e një pikë katër milionë) lekë për shpenzime kapitale.

2. Ky fond të përballohet nga të ardhurat e parashikuara të vitit 2010 për Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit.

3. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

DETAJIMI I FONDIT LIMIT TË SHPENZIMEVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
RADIOS DHE TELEVIZIONIT PËR VITIN 2010

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	
1	Paga	47
2	Sigurime shoqërore	6.5
3	Materiale	11.5
4	Shërbime	14.3
5	Shpenzime për botimin e buletinit të KKRT-së	1.5
6	Investime	21.4
	Shpenzime totale	102.2